



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA VI**

**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës  
Mbledhja nr. 26

Prishtinë, më 23.10.2018, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, zëvendëskryetar i parë, Zoran Mojsilović, zëvendëskryetar i dytë, Fatmir Xhelili, Ismet Beqiri, Bahrim Shabani, Aida Dërguti, Xhelal Sveçla, Fadil Beka, anëtarë.

**Munguan:** Ramiz Kelmendi dhe Daut Haradinaj.

**Nga stafi mbështetës i komisionit:** Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

**Mbledhjen e kryesoi,** Haxhi Shala , kryetar i komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

**Rend i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Formimi i grupeve punuese për Projektligjin nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligjin nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin nr. 06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës;
3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve për Projektligjin nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale;
4. Të ndryshme.

*Kryetari i komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua me vërejtje.*

*( Vërejtje u bë nga nënkryetari i komisionit Zoran Mojsilović, i cili ishte kundër pikës së dytë të rendit të ditës.*

**Kryetari**, theksoi se edhe pse z. Mojsilović është kundër pikës së dytë të rendit të ditës, ne do të vazhdojmë me pikat vijuese, me pakon e projektligjeve për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

## **2. Formimi i grupeve punuese për Projektligjin nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligjin nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin nr. 06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës**

**Kryetari** propozoi që të bëhet formimi i grupeve punuese për shqyrtimin e këtyre projektligjeve.

**Fatmir Xhelili**, sa i përket grupeve punuese për shqyrtimin e projektligjeve, theksoi se do të ishte më praktike formimi i një grupi punues, që do të punonte në tri projektligjet.

**Rexhep Selimi**, theksoi se pajtohet me qëndrimin e z. Xhelili, me formimin e një grupi punues, pasi tematika është e njëjtë dhe do të jetë e nevojshme krahasimi gjatë punës së grupit punues. Propozoi që kryesues i grupit punues të jetë kryetari i komisionit dhe pjesëmarrja të jetë sipas interesit dhe dëshirës, pasi siç shihet që në komision ka anëtar që nuk e votojnë dhe përkrahin këto projektligje.

**Ismet Beqiri**, theksoi se e mbështet qëndrimin që mos të ketë ndarje në grupe punuese, por në tërësi të jetë i gjithë komisioni.

**Rexhep Selimi**, theksoi se formalisht duhet të formohet grupi punues dhe kryesues të jetë kryetari.

**Zoran Mojsilović**, lidhur me formimin e grupeve punuese, theksoi se nuk do të jetë pjesë e grupit punues, por ky është takim i komisionit.

**Kryetari**, më tutje theksoi se për pakon e projektligjeve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, është planifikuar që të organizohet një punëtori, gjithashtu edhe organizimi i dy dëgjimeve publike, në Prizren dhe në Çagllavicë, kjo për shkak të përbërjes nga komunitetet jo shumicë të këtyre qyteteve dhe kjo me qëllim të diskutimit më nga afër me qytetarët, lidhur me projektligjet e FSK-së.

*Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës me 8 (tetë) vota për dhe 1 (një) kundër, nxori këtë:*

## VENDIM

*Formohet grupi punues për Projektligjin nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligjin nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin nr. 06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës, me këtë përbërje: Haxhi Shala, kryetar, Rexhep Selimi, Daut Haradinaj, Fatmir Xhelili, Ismet Beqiri, Fadil Beka, Bahrim Shabani, Aida Dërguti, Xhelal Sveçla, anëtarë.*

### **3. Shqyrtimi i propozim-amendamenteve për Projektligjin nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale**

**Kryetari** ia dha fjalën z. Fatmir Xhelili, kryesues i grupit punues për Projektligjin nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale.

**Fatmir Xhelili**, theksi se grupi punues ka shqyrtuar projektligjin dhe janë realizuar tri takime me përfaqësuesit e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Shoqatës së Bankave të Kosovës. Më tutje, theksoi se janë dy çështje, për të cilat duhet të diskutohet dhe të vendoset në komision.

Çështja e parë dhe që është më e rëndësishmja, është platoja e gjobës së dënimit që ka të drejtë të shqiptojë agjencia. Sipas direktivave të BE-së, është dënim shumë i madh, 2 deri në 4 për qind bruto fitimit të vitit paraprak të kompanive dhe me një tavan deri në njëzet milionë. Pas shumë konsultimeve dhe propozimeve, është konstatuar se është shumë e madhe për Kosovën, pasi vënia e gjobave të tilla do të ndikonte te kompanitë vendore, të cilat nuk kanë aq fitime dhe qarkullime të mëdha.

Propozimi më konkret që ka dalë nga grupi punues është që gjoba të jetë prej 2 deri në 4 për qind e fitimit të vitit paraprak dhe një tavan prej një milion. Kjo është pikë e ndjeshme dhe duhet të diskutohet edhe në këtë takim.

Ndërsa, çështja e dytë, ka të bëjë me amendamentin e 26, është propozuar që mandati i drejtorit të agjencisë të jetë shtatëvjeçar, pa mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër. Për këtë pikë janë menduar dy variante që komisionari të ketë mandat 5 vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje, ndërsa sa i përket kriterëve të përzgjedhjes, duhet të përcaktohen kriteret dhe të jenë të përafërta me agjencitë tjera dhe këto duhet të diskutohen në komision.

**Rexhep Selimi**, theksoi se përkrah punën e grupit punues për këtë projektligj dhe i përkrah propozim-amendamentet e grupit punues.

**Aida Dërguti**, theksoi se e konsideron si problematike çështjen tek amendamenti 36, çështjen e vendosjes së tavanit prej një milion, pasi nëse bëhet fjalë për kompani të mëdha që kanë fitime të mëdha, është e pranueshme, ndërsa për bizneset e vogla është e dëmshme, duke konsideruar që nuk e vlerëson si të dobishme, në interes të vendit vendosjen e gjobave të tilla.

**Fatmir Xhelili**, duke iu referuar normës që përkufizon këtë çështje, siç është në tekstin e projektligji: "Në rast se Agjencia konstaton se ka shkelje të rëndë dhe në masë të gjerë të të

dhënave personale, mund të vendosë gjobë nga njëzet mijë (20.000) € deri në dyzet mijë (40.000) €, ose në rastin e një kompanie apo ndërmarrjeje, mund të vendosë gjobë 2% deri 4% të qarkullimit të përgjithshëm vjetor të vitit financiar paraparak, në përputhje me Rregulloren (EU) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016”. Ndërsa, sa i përket asaj që a e vendos Kuvendi një milion apo mbetet me 2 deri në 4 për qind të qarkullimit vjetor paraparak, këtu është esenca. Po ashtu, theksoi se në këtë kohë është sfidë për shtetin sulmi kibernetik, andaj propozoi që të caktohet taveni një milion e më pas, kur të bëhet plotësim-ndryshimi i Ligjit për kundërvajtje, të bëhet edhe ky ndryshim.

**Xhelal Sveçla**, shtoi se është e qartë se nëse bëhen shkelje, dënohet me 2 deri në 4 për qind të fitimit paraparak, duke shtuar që është për, që kjo gjobë të mbetet ashtu siç është në projektligj.

**Aida Dërguti**, shtoi se propozimet që mendohet të jepen për këtë çështje, nuk duhet të jenë në kundërshtim me Ligjin për kundërvajtje.

**Fatmir Xhelili**, për këtë çështje, kërkoi që të jepet edhe pak kohë, pasi do të konsultohen edhe zyrtarët ligjorë të Kuvendit. Po ashtu, institucioni kompetent për caktimin e pagës së komisionarit është një pikë që duhet të diskutohet, pasi është Komisioni për Buxhet i Kuvendit apo Kuvendi.

**Xhelal Sveçla**, sa i përket mandatit për komisionarin, propozoi që të ketë një mandat të shkurtër, me mundësi rizgjedhjeje, p.sh. katër plus katër vjet.

**Fatmir Xhelili**, shtoi se mandati që është propozuar për shtatë vjet, është bërë edhe sipas modelit që kanë disa agjenci të pavarura në Kosovë.

*Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rendit të ditës, pas diskutimeve, me vota unanime, nxori këtë:*

#### **REKOMANDIM**

*Miratohen propozim-amendamentet për Projektligjin nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe procedohen për opinion te komisionet e përhershme të Kuvendit të Kosovës.*

#### **4. Të ndryshme**

Nuk pati çështje për të diskutuar.

**Kryetari**, me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi takimin e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:40.

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

---

**Haxhi Shala**

